



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 2550/prot.

Pogradec, më 29.06.2023

VENDIM

Nr. 63, DATË 27/06/2023

PËR

MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM, PER QELLIME
STUDIMI TE POTENCIALIT TE ERERAVE, DHE NDERTIMIN E
PARQEVE ELOIKE NE BASHKINE E POGRADECIT.

Ne mbeshtetje te; pikes 2 te nenit 8, pikes 1.2 genna "a" te nenit 9, te pikave S dhe 6 te nenit 27 dhe shkronjes "e" te nenit 54 te Ligjit Nr.139/2015 "Per veteqeverisjen Vendore", I ndryshuar, Ligjin Nr. 8480 date 27.05.1999 "Per funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shteterore dhe enteve publike" ,Ligjit Nr.7/2017 "Per nxitjen e perdorimit te energjise elektrike nga burimet e rinovueshme", piken 4 te nenit 12 te Ligjit Nr. 57/2020, "Per pyjet", Kreun VT te Ligjit Nr.7850, date 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikes se Shqiperise", I ndryshuar, Ligjin Nr. 43/2015 "Per sektorin e energjitikes", Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 433, date 08.06.2016 "Per transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listes se inventarit, dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit dhe ish-komunave/ bashkive", i ndryshuar, Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 822, date 7.10.2015 "Per miratimin e rregullave dhe procedurave te ndertimit te kapaciteteve te reja prodhuese te energjise elektrike, qe nuk jane objekt koncesioni", neni 20 dhe neni 23 te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.391, date 21.06.2006 "Per percaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe kullotave", i ndryshuar, shkronjes "j" te pikes 22 te Udhhezimit te Ministrit te Mjedisit Nr. 1, date 09 .06.2016 "Per rregullat, procedurat e kerkimit, te shqyrtimit e te miratimit te kerkcsave per dhënien në përdorim te fondit pyjor/kullosor publik", si dhe bazuar në shkresën Nr. 775-1 Prot, date 28/10/2021, e Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise, me lëndë: "Kërkesë për bashkepunim mbi ankandin per energjinë e erës" dhe shkresën me nr. 2431 datë 13/06/2023 drejtuar Bashkise Pogradec nga shoqeria Renx Albania me lëndë "Kerkese per marrje me qera afatgjate te siperfaqes prej 2.26 Ha", në vijim të VKB-së Pogradec me nr. 114, datë 16/12/2021, me propozim te Kryetarit te Bashkise, Keshilli I Bashkise,

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim dhënien në përdorim, me qëllim studimi te potencialit te ererave, me synim ndertimin e parqeve eloike, me të dhënat si më poshtë:

Nr	Z.K	Nr	Vëndodhja	Siperf në	Objekti kerkeses
----	-----	----	-----------	-----------	------------------

		Pasur		m2	
1	1832	460	Dardhas - Pretushe	400	Marrje perdorim Pasurie
2	2420	433	Dardhas - Pretushe	400	Marrje perdorim Pasurie
3			Dardhas - Pretushe	400	Marrje perdorim Pasurie
4	2420	436	Dardhas - Pretushe	400	Marrje perdorim Pasurie
5	2420	435	Dardhas - Pretushe	400	Marrje perdorim Pasurie
6	1442		Dardhas - Pretushe	400	Marrje perdorim Pasurie
7			Dardhas - Pretushe	400	Marrje perdorim Pasurie
8	1214	845	Alarup	400	Marrje perdorim Pasurie
9	1208	433	Petrushë – Lin	400	Marrje perdorim Pasurie
10	1387	461	Alarup	400	Marrje perdorim Pasurie
11	3047	406	Dardhas – Petrushe	400	Marrje perdorim Pasurie
			Total	4.400	

2. Administrata e Bashkisë do të kryejë verifikimin e statusit juridik dhe azhornimin e pronave të mësipërme dhe të zbatojë legjislacionin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme juridike.
3. Këshilli I Bashkisë për sipërfaqet e tjera të kërkuqara nga subjekti sipas listës dhe hartës bashkëngjitur këtij vendimi, shpreh dakortësinë për ushtrimin e aktivitetit të kërkuar gjithnjë duke plotësuar procedurat ligjore për pronësinë dhe ushtrimin e aktivitetit në zona të mbrojtura.
4. Afati i dhënies me qera të jetë 9 vite, me të drejte ripertëritje, sipas periudhes të percaktuar në projekt, dhe studimin e fizibilitetit të dorëzuar nga kërkuuesit në konkurim.
5. Ky proces të kryhet sipas percaktimeve të Vendimit Nr. 54, datë 05.02.2014 të Keshillit të Ministrave "Për percaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhenies me qira, enfitoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.
6. Tarifat për dhënien në përdorim/qera të këtyre pasurive, të aplikohen sipas shkronjës "c", pika 1 Kreu III të Vendimit Nr. 54, datë 05.02.2014 të Keshillit të Ministrave "Për percaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhenies me qira, enfitoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.
7. Shoqëria kërkuuese të përdorë pasuritë e mësipërme për ushtrimin e aktivitetit të saj sipas objektit të parashikuar në kërkesën e saj dhe studimin e fizibilitetit të paraqitur për marrjen në përdorim të pasurive.
8. Të Autorizohet Kryetari i Bashkisë Pogradec për lidhjen e kontratës, sipas tekstit bashkëngjitur këtij projektvendimi mbas përfundimit të procedurave konkurruese.
9. Vendimi fillon ekzekutimin në momentin që do të do të vihen në dispozicion certifikatat e regjistrimit të pronësive në emër të Bashkisë Pogradec.
10. Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe administrata e Bashkisë Pogradec.
11. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI